

**FEDERATA E KARATESË E KOSOVËS**  
**KOSOVA KARATE FEDERATION**



**RREGULLORE PËR ÇËSHTJE JURIDIKE**

Prishtinë, 2021

## **DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

### **Neni 1**

#### **QËLLIMI**

1. Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i procedurave për shërbime juridike në Federatën e Karatesë, qëkanë të bëjnë, por nuk kufizohen me:
  - a) Nismën dhe procedurën për hartimin dhe miratimin e rregullores;
  - b) Shpalljen e rregullores, kthimin për rishqyrtim dhe mosmarrveshjen e vendimit për shpallje ose kthim;
  - c) Referimi i Çështjeve (opinion i Komisionit për çështje të ndryshme)

### **Neni 2**

#### **FUSHËVEPRIMI**

Kjo rregullore zbatohet nga Departamenti për Çështje Juridike i Federatës së Karatesë së Kosovës.

### **Neni 3**

#### **PËRKUFIZIMET**

1. Shprehje e përdorura në këtë rregullore kanë këtë kuptim:
  - a. WKF - World Karate Federation;
  - b. EKF - European Karate Federation;
  - c. BKF - Balkan Karate Federation;
  - d. KOK - Komiteti Olimpik i Kosovës;
  - e. FKK- Federata e Karatesë e Kosovës;
  - f. ZFK - Zyrja e Federatës së Karatesë;
  - g. BEFK- Bordi Ekzekutiv i Federatës se Karatesë se Kosovës;
  - h. Kryetari/ja – Kryetari i Federatës se Karatesë se Kosovës;
  - i. Sekretar - Sekretari i Përgjithshëm i Federates së Karatesë;
  - j. Zyrtar – nënkupton të punësurit në Federatës.

### **Neni 4**

#### **Komisioni për legjislacion dhe përbërja e tijë**

1. Komisioni për legjislacion përbëhet nga 3 anëtarë:
  - a) Kryesuesi i komisionit (kryetari) dhe 2 anëtarë të komisionit për legjislacion zgjidhen nga Bordi Ekzekutiv i FKK-së.
  - b) Dy anëtarë i zgjedhë kryesuesi, respektivishtë kryetari i Komisionit për legjislacion.

2. Nisma për hartimin, ndryshim plotësimin e Statutit, Rregulloreve dhe akteve tjera normative në Federatën e Karatesë se Kosovës.

#### **Neni 5**

##### **Kriteret për përzgjedhje të kryesuesit të komisionit**

1. Kryesuesi i Komisionit Legjislativ do të përzgjedhet me konkur të shpallur nga FKK.
2. Kriteret për përzgjedhje të kryesuesit janë si në vijim:
  - a. Një CV
  - b. Ai/ajo duhet të jetë i/e familjarizuar me rregullat e karatesë
  - c. Të ketë diplomë Juristi/Administratë Publike
  - d. 5 vite përvojë në karate
  - e. Aplikacioni i FKK-së i plotësuar me referenca që ndërlihdën me përvojën dhe punën me çështje legjislative (në sport).

#### **Neni 6**

##### **PROPOZIMI PËR HARTIMIN E RREGULLORES SË FEDERATËS SË KARATESË**

1. *Kryetari, Sekretari dhe anëtarët e Bordit Ekzekutiv të Federatës së Karatesë kanë të drejtën të propozojnë fillimin e procedurës për hartimin, ndryshim plotësimin e Statutit. Rregulloreve dhe akteve tjera normative në Federatën e Karatesë se Kosovës*
2. *Komisioni shqyrton propozimin e pranuar për hartimin e rregulloreve apo akteve tjera normative dhe propozimin që i plotëson kushtet e përcjell për miratim tek Sekretari.*
3. *Procedura për hartimin e rregullores fillon vetëm pas miratimit të propozimit nga Bordi Ekzekutiv i FKK-së.*
4. *Nëse Bordi nuk vendos ndryshe, procedura për hartimin e rregulloreve dhe akteve tjera normative fillojnë pas miratimit të propozimit nga Sekretarit.*
5. *Të gjitha nismat legjislative duhet t'i përmbahen standardeve për hartimit të rregulloreve dhe akteve tjera normative.*

#### **Neni 7**

##### **Procesi i konsultimit**

1. Gjatë fazes së procesit të konsultimit duhet përdorur metodat dhe mënyrat që janë më adekuate në mënyrë të duhur, palet që duhet konsultuar në secilin proces të nismave të ndryshme për ndryshim plotësimeve dhe rregulloreve të reja janë si më poshte:
  - a) *Kryetari;*
  - b) *Sekretari,*
  - c) *Antaret e Bordit,*



- d) *Trajnerët dhe Zyrtarët e tjerë që kanë njohuri për çështjen që ju referohet komisioni,*
- e) *Palaet tjera të involvuara në procesë.*

## **Neni 8**

### **Finalizimi**

1. Pas finalizimit të hartimit të rregullores, komisioni përgjegjës ia dërgon rregulloren për çështje juridike Bordit të FKK-se për miratim.
2. Nëse Bordi i FKK-se kërkon ndryshim, plotësim të rregullores, rregullorja kthehet prap në plotësim.
3. Pas plotësimit të rregullores, rregullorja ridërgohet në Bordin Ekzekutiv të FKK-së për miratim.

## **Neni 9**

### **Miratimi i rregullores**

1. Pas miratimit të rregullores nga Bordi Ekzekutiv i FKK-se, Kryetari i FKK-se, nënshkruan rregulloren dhe pas nënshkrimit nga kryetari rregullorja hyjë automatikisht në fuqi.

## **Neni 10**

### **Shqyrtimi i propozimeve**

1. Kryetari i Komisionit cakton personin përgjegjës për çështjen përkatëse.
2. Nëse propozimi përkatës nga anëtarë nuk është i kompletuar, Komisioni kërkon plotësimin e tij.
3. Opinioni ligjor nga Komisioni dërgohet në Bordin Ekzekutiv përmes Sekretarit të Përgjithshëm të FKK-së.
4. Afati kohorë për opinionin Juridik është 8 ditë pune.

## **Neni 11**

### **SHFUQIZIMI**

1. Shfuqizimi i rregulloreve dhe akteve tjera normative behet pasi rregullorja e njejte apo akti tjeter normative miratohet nga kryetari/e, nenshkruan apo miraton nje akte tjeter normativ qe rregullone fushen e njejte.

## Neni 12

### ZBATIMI

1. Pas miratimit nga Bordi dhe nenshkrimet te kryetarit, secili akt normative/rregullore automatikisht zbatohet per te gjithë antaret dhe komisionet ne FKK.


## Neni 13

### Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi nga data e nënshkrimit të Rregullores nga kryetari i FKK-së.

Prishtinë, 19 qershor 2021

Ismet Krasniqi



Kryetar